



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.671/ 5 prot.

Datë 25.03.2025

V E N D I M
Nr. 403/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.03.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik BOE “GEGA CENTER GKG”, shpk & “GEGA OIL GROUP” shpk në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-38256-02-17-2025, me objekt: “Blerje Karburant”, me fond limit 1,981,853.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 03-03-2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Dekorit dhe Eventeve Tiranë.

Shfuqizimi i kualifikimit të operatorit ekonomik “A & T” SHPK në procedurën e mësipërme.

Ankimues:

Operatori ekonomik BOE “GEGA CENTER GKG” shpk & “GEGA OIL GROUP” shpk me nipt K66801001T, k76911001E me adresë: Njësia Nr.1, Rruga “Ali Demi”, godina nr. 110, pasuria me Nr.8/745, Zonë Kadastrale 8150.

Autoriteti Kontraktor:

Ndërmarrja e Dekorit dhe Eventeve Tiranë.

Adresë: Rruga “Beqir Luga”, Tiranë.

Subjekt i Interesuar:

Operatori ekonomik “A & T me NIPT L32320008H me adresë: Rruga “Ibrahim Rugova”, Kulla Sky Tower, Kati 7, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar,
Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 18-02-2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-38256-02-17-2025, me objekt: “Blerje Karburant”, me fond limit 1,981,853.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 03-03-2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Dekorit dhe Eventeve Tiranë.

II.2. Në datën 03-03-2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 07.03.2025 ka kryer rivlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

BOE A&T SHPK dhe 2A2F-L-OIL SHPK 1981793 lekë me marzh fitimi 15.60 lekë
kualifikuar

BOE "GEGA CENTER GKG GEGA OIL GROUP" SHPK SHPK me marzh fitimi 25 lekë
Skualifikuar

II.4. Në datën 10.03.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim - Fituesi paraparak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.5. datën 10.03.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/5119 si dhe nr. 671/2025 prot, datë 10.03.2025 i BOE "GEGA CENTER GKG" shpk & "GEGA OIL GROUP" shpk, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e tij dhe kualifikimin e BOE "A&T" shpk & "2A2F-L-OIL" shpk, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.6. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 671/1 datë 11.03.2025.

II.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente nga operatorë ekonomikë, në cilësinë e subjektit të interesuar, në përputhje me nenin 113 të LPP-së.

II.8. Me shkresën nr.38/9 prot., datë 17.03.2025 me objekt "Kthim përgjigje", protokolluar me tonën me nr.671/2 prot., datë 19.03.2025, autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin nr.38/8 prot., datë 13.03.2025 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik BOE "GEGA CENTER GKG" shpk & "GEGA OIL GROUP" shpk.

II.9. Referuar vendimit të KSHA nr. nr. 38/8 prot., datë 13.03.2025, rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimes, BOE "GEGA CENTER GKG" shpk & "GEGA OIL GROUP" shpk dhe në përfundim ka vendosur pranimin e pjesës së ankesës, duke arsyetuar si më poshtë:

"..Në vijim të ankesës së Operatorit Ekonomik BOE "GEGA CENTER GKG" shpk & "GEGA OIL" shpk, me nr.38/6 prot datë 10.03.2025 dhe marrë dijeni nga faqja zyrtare e KPP datë 11.03.2025, pasi ankesa ende nuk është administruar pranw ndërmarrjes së Dekorit dhe Eventeve, në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt "Blerje Karburant" parashtrojmë për paraqitjen si me vijon: Më datë 17.02.2025 është ngarkuar në sistemin e APP- se procedura e hapur e thjeshtuar, shërbim me numër REF-38256-02-17-2025 pa TVSH, dhe me afat të fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave më 3.03.2025. Anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave kanë mbajtur procesverbalin e hapjes dhe vlerësimit, në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt "Blerje karburant" me nr. REF-38256-02-17-2025, me fond limit: 1,981,853 Leke pa TVSH.

Nga hapja e sistemit kanë rezultuar pjesëmarrës si më poshtë:

1. Operatori Ekonomik "GEGA CENTER GKG" NIPT K66801001T, nuk ka ngarkuar në sistem formularin e ofertes ekonomike, me norme fitimi 25%.

2. Operatori Ekonomik "A&T" me NIPT L32320008H me oferte ekonomike 1,981,793 lekë pa TVSH, me norme fitimi 15.6%. Nisur nga dokumentat justifikues të dorëzuara në sistem nga operatorët ekonomik, KVO vuri re që "BOE "GEGA CENTER GKG & GEGA OIL" nuk ka ngarkuar në sistem Shtojcën 1 dhe të 3 të DST që plotësohen nga Operatorët Ekonomik pjesëmarrës në procedurë, por vetëm Shtojcën 2 me normën e fitimit. Nisur nga ankesa e operatorit ekonomik KSHA vendosi si vijon: Te korrigjohet vlerësimin e KVO duke vlerësuar procedurën e prokurimit në bazë të normës së fitimit, dhe të bëjë ndryshimet e nevojshme që "BOE "GEGA CENTER GKG & GEGA OIL" të kualifikohet si oferte e rregullt. Me tej në formularin e njoftimit të fitimit paraprak do vihet norma e fitimit me të cilën kanë ofertuar operatorët ekonomik pjesëmarrës si vijon:

1. Operatori Ekonomik "GEGA CENTER GKG" NIPT K66801001T, me norme fitimi 25%.

2. Operatori Ekonomik "A&T" me NIPT L32320008H me norme fitimi 15.6%.

Ndërsa në lidhje me shfuqizimin e kualifikimit të operatorit ekonomik "A&T", rezulton që ka ofertuar me norme fitimit me të ulet se "GEGA CENTER GKG" kështu që kualifikohet si e sukseshme në këtë procedurë.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues BOE "GEGA CENTER GKG & GEGA OIL" SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me arsye skualifikimi se *"nuk ka ngarkuar në sistem formularin e ofertës ekonomike dhe listën e çmimeve, përkatësisht Shtojcën 1 dhe 3 sipas DST."* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. shkresën nr. 38/9 prot., datë 17.03.2025 me objekt "Kthim përgjigje", protokolluar me tonën me nr. 671/2 prot., datë 19.03.2025, autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin nr.38/8 prot., datë 13.03.2025 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik BOE "GEGA CENTER GKG" shpk & "GEGA OIL GROUP" shpk.

III.1.2 Referuar vendimit të KSHA nr. nr. 38/8 prot., datë 13.03.2025, rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues, BOE "GEGA CENTER GKG" shpk & "GEGA OIL GROUP" shpk dhe në përfundim ka vendosur pranimin e pjesshëm të ankesës, duke arsyetuar si më poshtë:

"..Në vijim të ankesës së Operatorit Ekonomik BOE "GEGA CENTER GKG" shpk & "GEGA OIL" shpk, me nr.38/6 prot datë 10.03.2025 dhe marrë dijeni nga faqja zyrtare e KPP datë 11.03.2025,pasi ankesa ende nuk është administruar pranw ndërmarrjes së Dekorit dhe Eventeve,ne lidhje me procedurën e prokurimit me objekt "Blerje Karburant" parashtrojmë për paraqitjen si më vijon:

Më datë 17.02.2025 është ngarkuar në sistemin e APP- se procedura e hapur e thjeshtuar, shërbim me numër REF-38256-02-17-2025 pa TVSH, dhe me afat të fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave më 3.03.2025.Anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave kanë mbajtur procesverbalin e hapjes dhe vlerësimit, në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt "Blerje karburant" me nr. REF-38256-02-17-2025, me fond limit: 1,981,853 Leke pa TVSH.

Nga hapja e sistemit kanë rezultuar pjesmarres si më poshte:

1. Operatori Ekonomik "GEGA CENTER GKG" NIPT K66801001T, nuk ka ngarkuar në sistem formularin e ofertës ekonomike, me norme fitimi 25%.

2. Operatori Ekonomik "A&T" me NIPT L32320008H me oferte ekonomike 1,981,793 lekë pa TVSH, me norme fitimi 15.6%. Nisur nga dokumentat justifikues të dorëzuara në sistem nga operatorët ekonomik, KVO vuri re që "BOE "GEGA CENTER GKG & GEGA OIL" nuk ka ngarkuar në sistem Shtojcën 1 dhe të 3 të DST që plotësohen nga Operatorët Ekonomik pjesmarrës në procedure por vetëm Shtojcën 2 me normën e fitimit.

Nisur nga ankesa e operatorit ekonomik KSHA vendosi si vijon:

Te korrigjioje vlerësimin e KVO duke vlerësuar procedurën e prokurimit në bazë të normës së fitimit, dhe të bëjë ndryshimet e nevojshme që "BOE "GEGA CENTER GKG & GEGA OIL" të

kualifikohet si oferte e rregullt. Me tej ne formularin e njoftimit të fituesit paraprak do vihet norma e fitimit me të cilën kanë ofertuar operatorët ekonomik pjesmarrës si vijon:

1. Operatori Ekonomik "GEGA CENTER GKG" NIPT K66801001T, me norme fitimi 25%.

2. Operatori Ekonomik "A&T" me NIPT L32320008H me norme fitimi 15.6%.

Ndersa ne lidhje me shfuqezimin e kualifikimit te operatorit ekonomik "A&T", rezulton qe ka ofertuar me norme fitimit me te ulet se "GEGA CENTER GKG" keshtu qe kualifikohet si e sukseshme ne kete procedure.

III.1.3. Neni 30 i LPP-së i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.5. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente nga operatorë ekonomikë të interesuar, në përputhje me nenin 113 të LPP-së.

Në këto kushte, bazuar në pikën 3, germa a të nenit 115 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen administrative për pjesën e pranuar lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues BOE “GEGA CENTER GKG” shpk & “GEGA OIL GROUP” shpk.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik BOE “GEGA CENTER GKG” shpk & “GEGA OIL GROUP” shpk, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e BOE “A&T” shpk & “2A2F-L-OIL” shpk se: “2) *Nga publikimi i njoftimit të fituesit mesa shohim operatori ekonomik ka ofertuar në vlerë më pak se fond limit Vlera (1,981,793.1 Lekë pa TVSH) kjo vlerë është shpallur fituese nga AK ndërkohë tek njoftimi paraprak i fituesit **nuk paraqitet norma e fitimit të karburantit**. Kërkojmë skualifikimin e operatorit ekonomik të shpallur fitues nga AK dhe vlerësimin e duhur të ofertës tonë ekonomike e shprehur sipas kërkesave në DST me normë fitimi ”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1 Në shtojcën 2 të dokumenteve standarde të tenderit, **“Formulari ofertës ekonomike”** autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojca]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE³

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: [Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i [Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: [shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE], përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne [vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rast], nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës [vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit].

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor], në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për [vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE] në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhezimet për Operatoret Ekonomike;
2. Njoftimin e Kontratës;

3. Kriteret e Përzgjedhjes;

4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;

5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti kontraktor përlogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date;
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

III.1.2. Për plotësimin e kriterëve të sipërcituara, nga ana e operatorit ekonomik BOE “A&T” shpk & “2A2F-L-OIL” shpk është paraqitur në ofertë dokumentacioni si vijon:

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatorit ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data: 03.03.2025

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit REF-38256-02-17-2025

Për: Ndermarrja e Dekorit dhe Eventeve

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i BOE A&T sh.a me nipt L32320008H & 2A2F L-OIL sh.p.k me nipt L41915013M

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **Blerje karburant** përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne BOE A&T sh.a me nipt L32320008H & 2A2F L-OIL sh.p.k me nipt L41915013M, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **Blerje Karburant**
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë **Autoritetit Kontraktor "Ndermarrja e Dekorit dhe Eventeve"**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për 09100000-0 në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, pa TVSH, është: 1,981,793.1 [Një milion e nentëqind e tetëdhjetë e një mijë e shtatëqind e nentëdhjetë e tre pike një];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: 2,378,151.72 [Dy milion e treqindë shtatëdhjetë e tetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e një pike shtatëdhjetë e dy];

7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

- d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit në vlerë absolute
1.	Diesel 10 ppm	leke/lt
2.	Benzine (premium Unl 10 ppm)	leke/lt

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë <u>3/3/2025</u>	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: 03.03.2025

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: REF-38256-02-17-2025

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): BOE A&T sh.a me nipt & 2A2F L-OIL sh.p.k me nipt

Monedha: ALL

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	6
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia e pritshme	çmimi per njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.	Diesel 10 ppm	8570 litra			
2.	Benzine (Premium Uni 10 ppm)	5450 litra			
3.					
4					
Çmimi total (Mallrat)					
Çmimi Neto na TVSH					

TVSH (%)	
Çmimi total me TVSH:	
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Data 3/3/2025	



III2.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të

barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.4. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

III.2.5 Për sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimues se KVO duhet të skualifikonte operatorin ekonomik BOE “A&T” shpk & “2A2F-L-OIL” shpk duke pretenduar se operatori ekonomik i sipërcituar nuk ka ofertuar me normë fitimi, pasi AK *ndërkohë tek njoftimi paraprak i fituesit* **nuk paraqitet norma e fitimit të karburantit**. Kërkojmë skualifikimin e operatorit ekonomik të shpallur fitues nga AK dhe vlerësimin e duhur të ofertës tonë ekonomike e shprehur sipas kërkesave në DST me normë fitimi”, konstatohet, se në DST nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date;

b) elementet fiskale;

c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;. Në përmbushje të kësaj kërkesë nga ana e subjektit BOE “A&T” shpk & “2A2F-L-OIL” shpk është ngarkuar në sistem Formulari i Ofertës Ekonomike. Nga verifikimi i kryer i këtij formulari vërehet se operatori ekonomik ka ofertuar me çmim total dhe ka përcaktuar normën e fitimit në formularin e ngarkuar. Sa më sipër cituar Komisioni i Prokurimit publik pasi verifikoi këtë dokumentacion të ngarkuar ne SPE konstatoi se lidhur me kërkesën e autoriteti kontraktor operatori ekonomik BOE “A&T” shpk & “2A2F-L-OIL” shpk ka ngarkuar formularin e ofertës në përputhje me atë çka është kërkuar nga Autoriteti Kontraktor. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron lidhur me pretendimin e tij se AK ka kryer një vlerësim jo të drejtë, pasi nuk është pasqyruar norma e fitimit të karburantit në njoftimin paraprak të fituesit lidhur me Fituesin paraprak të kësaj procedure prokurimi, pasi nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE vërehet se ka përcaktuar normën e fitimit në bazë të kërkesave të AK.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga BOE “GEGA CENTER GKG” shpk & “GEGA OIL GROUP” shpk për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-38256-02-17-2025, me objekt: “Blerje Karburant”, me fond limit 1,981,853.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 03-03-2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Dekorit dhe Eventeve Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor të bëjë rivlerësim të procedurës së prokurimit, në zbatim të vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës nr.38/8 prot., datë 13.03.2025.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit të KSHA -së, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në buxhet të shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik BOE “GEGA CENTER GKG” shpk & “GEGA OIL GROUP” shpk.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaïd Myzyri

